

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË FATKEQËSISË NATYRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nëpërmjet këtij akti normativ synohet të përcaktohet kuadri i nevojshëm ligjor, që do të mundësojë rimëkëmbjen e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësive të tjera, që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat për shkak të intensitetit e të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve qendrore dhe vendore, që kanë kompetenca në marrjen e masave për përballimin e këtyre situatave.

Situata, me të cilën u përball vendi ynë si rezultat i tërmetit të datës 26 nëntor 2019, bën të nevojshëm propozimin e një kuadri rregullator i cili duhet të normojë krijimin dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin e rindërtimin e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, programet e rindërtimit, krijimin e fondit të posaçëm të rindërtimit dhe procedurat përkatëse të përdorimit të tij dhe llogaridhënies.

II. VLERËSIM I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA

Duke qenë se akti normativ propozohet të miratohet në kushet e nevojës dhe urgjencës nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave, përgjatë vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji i ri nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ka hedhur bazat për zbatimin efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore e të tjera dhe mbrojtjen civile, të cilat, nga ana e tyre, kanë ndikim thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Pavarësisht kësaj, përparësia kryesore e të gjitha organeve shtetërore në rast të situatave të fatkeqësive natyrore dhe të

fatkeqësive të tjera, është ndihma sa më e shpejtë dhe reagimi i menjëhershëm për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe marrja e masave të shpejta e efektive të rimëkëmbjes.

Referuar të dhënave të Bankës Botërore, vendi ynë ka humbje mesatare vjetore nga tërmetet që vlerësohet të jetë 6.23% të PPB-së dhe humbje mesatare vjetore nga përmytjet 1.56% e PBB-së.

Sipas Bankës Botërore, humbjet nga një tërmet i madh me periudhë rikthimi 250-vjeçare do të ishin 60% e PBB-së, ndërsa nga një tërmet me periudhë rikthimi 100-vjeçare 30% e PBB-së.

Në këtë aspekt, vendi ynë duhet të ketë një kuadër rregullator i cili, përveç parandalimit, koordinimit dhe përgatitjes në rast të fatkeqësive natyrore, duhet të rregullojë menaxhimin në mënyrë efektive të pasojave afatmesme dhe afatgjata të gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera duke parashikuar detyrat e autoriteteve përgjegjëse në këtë aspekt, programet dhe procedurat përkatëse të rindërtimit me qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe të sigurisë kombëtare.

Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka qëllim garantimin e kthimit të çdo subjekti të prekur nga fatkeqësia natyrore në gjendjen fillestare, nxitjen e praktikave që ulin mundësinë për shkaktimin e pasojave në të ardhmen nga fatkeqësitë natyrore si dhe forcimin e aftësisë së komuniteteve të prekura për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen.

Autoritetet publike përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve e të teknikave që parandalojnë rreziqet e reja të fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me objektivat sociale të shtetit të sanksionuara nga neni 59 i Kushtetutës, parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, strehimit të përshtatshëm, barazisë dhe mosdriminimit, informimit dhe transparencës, si dhe parimin e kontrollit dhe përgjegjshmërinë e burimeve financiare. Në thelb ky akt normativ përshkrohet nga koncepti “rindërto më mirë”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj **me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës**, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tillë, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj ku mund të përmendim vendimin nr.24, datë 10.11.2006, nr.1, datë 6.2.2013, nr.5, datë 5.2.2014, ka interpretuar kuptimin e termave “nevojë” dhe “urgjencë”. Sipas vendimmarjes së Gjykatës Kushtetuese *nevoja* dhe *urgjenca* janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen, rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë. Si raste të tilla përmenden **fatkeqësitë natyrore**, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, **nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike**. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislacioni ekzistues nuk i mundëson dot.

Nga ana tjetër, elementi *urgjencë* nuk mund të ekzistojë në vetvete pa *nevojën*, sepse *urgjenca* tregon vetëm një situatë që nuk mund të presë, ndërsa *nevoja* tregon substancën e saj, përcakton situatën që kërkon zgjidhje, tregon marrëdhënien shoqërore që kërkon rregullim ligjor. Kuptimin e tyre të vërtetë termat *nevojë* dhe *urgjencë* e manifestojnë në kuadër të situatës të rastit konkret, duke i vlerësuar në kohën kur është vërtetuar prania e tyre. Nga kuptimi i përmbajtjes së nenit 101 të Kushtetutës, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, Këshilli i Ministrave nxjerr akte normative për marrjen e masave përkatëse.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se prania e nevojës dhe urgjencës në kushtet e nxjerrjes së një akti normativ me fuqinë e ligjit është e lidhur me ekzistencën e vetë normës. Këtë opinion ka shprehur dhe jurisprudenca kushtetuese ndërkombëtare duke vlerësuar se ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ që ka fuqinë e ligjit. Nëse ekziston nevoja për nxjerrjen e një ligji, por pa ndonjë urgjencë të dukshme, qeveria nuk mund të ndërmarrë nismën për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, pasi kjo do të përbënte një detyrë të pushtetit ligjvënës. Vetëm kur situata e krijuar vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara, iniciativa ligjvënëse mund t’i kalojë qeverisë.

Nëpërmjet vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin nr.751, datë 29.11.2019, të Këshillit të Ministrave, ka

shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, për një periudhë jo më të gjatë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim ka parashikuar njëkohësisht edhe masat që duhet të merren gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga: institucionet publike; strukturat operationale të sistemit të mbrojtjes civile; subjektet private dhe shtetasit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme.

Nga tërmeti i datës 26.11.2019 rezulton se qarqet më të prekura janë: Durrësi, Tirana dhe Lezha. Sipas informacionit zyrtar që shoqëron këtë propozim rezulton se:

- Për Qarqet Tiranë dhe Durrës janë dëmtuar rëndë: 2002 banesa; 135 pallate dhe 60 pallate janë shpallur të pabanueshme. Ndërkohë rezulton se 4380 pallate dhe 543 banesa janë të dëmtuara lehtë.
- Për Qarkun Lezhë janë dëmtuar rëndë 1353 apartamente; 235 vila dhe 66 pallate. 45 pallate, 559 apartamente dhe 181 vila janë me dëmtime të mesme si dhe 263 pallate dhe 1297 apartamente dhe 57 vila janë me dëmtime të lehta.

Për sa i takon kohëzgjatjes maksimale të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Kushtetuta dhe ligji nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, parashikojnë një kohëzgjatje maksimale prej 30 ditësh. Duke mbajtur në konsideratë që gjatë 30 ditëve të para përfundoi faza e kërkim-shpëtimit dhe filloi faza e verifikimit të dëmeve, nevoja për përfundimin e fazës së verifikimit si dhe hartimit e zbatimit të masave afatshkurtra të rregullimit të pasojave me qëllim sigurimin e jetës dhe shëndetit të individëve, Këshilli i Ministrave i ka propozuar Kuvendit dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë deri më 31.3.2020.

Përsona të evakuuar si rezultat i situatës së fatkeqësisë natyrore nga tërmeti i datës 26.11.2019, rezulton të jenë 3224 persona pa kushte të sigurta strehimi. Emergjenca e lindur si pasojë e situatës së pasigurt dhe detyrimi kushtetues për plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim konsiderohet si shkak për urgjencë dhe për adresim nëpërmjet këtij akti normativ.

Njëkohësisht, procedurat parlamentare janë të pamjaftueshme për të sjellë rregullimin e duhur ligjor në kohë. Bazuar në rregulloren e Kuvendit nuk futet në kalendarin e punimeve pa kaluar të paktën dy javë nga momenti i paraqitjes së tij. Proceduralisht, do të duhet që projektligji të diskutohet nëpër komisionet, pastaj të votohet në seancë, si edhe t’i dërgohet Presidentit për shpallje. Më pas duhet që të botohet në “Fletoren zyrtare” dhe të kalojë të

paktën edhe një periudhe tjetër 15 - ditore që ndryshimet e propozuara të hyjnë në fuqi. Është e qartë se kjo procedurë kërkon një kohë të gjatë që mund të shkojë edhe deri në dy muaj nga momenti i depozitimit të nismës nga Këshilli i Ministrave deri në hyrjen e tij në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Akti normativ nuk synon përafrimin me ndonjë akt të veçantë të *acquis* së Bashkimit Evropian, por është në përputhje me parimet dhe standardet e sanksionuara në aktet ndërkombëtare ku mund të përmendim Konventën Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Kreu I “Dispozita të përgjithshme” trajton objektin, qëllimin dhe fushën e zbatimit si dhe subjektet e këtij akti normativ. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj nisme është rimëkëmbja e komuniteteve dhe territoreve të prekura si pasojë e fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe e fatkeqësive të tjera që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve dhe autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Subjektet e këtij akti normativ, në kuptim të këtij ligji, janë individët dhe familjet që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre. Akti normativ i shtrin efektet e tij edhe për tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilëve, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, i është dëmtuar selia e tyre ose të cilët mund të përfitojnë vetëm nga programi i masave për rimëkëmbjen ekonomike sipas parashikimeve të këtij ligji.

Individët/familja nuk përfitojnë nga dispozitat e këtij akti normativ nëse kanë në pronësi ose posedim të ligjshëm më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm.

Individët dhe familjet, banesa e të cilëve është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, por që nga autoritetet përgjegjëse është vlerësuar si e banueshme, nëse nuk

kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, përfitojnë kompensimin e dëmeve sipas parashikimeve të këtij ligji.

Subjektet, që kanë pësuar dëme në ndërtesa, jashtë territorit ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë, në rastet kur provohet se dëmet janë pasojë e fatkeqësisë natyrore, përfitojnë kompensimin e dëmeve sipas parashikimeve të këtij ligji.

Nuk janë subjekte përfituese subjektet e së drejtës tregtare në fushën e ndërtimit për ndërtesat ose njësitë brenda një ndërtese në pronësi të tyre, që janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, kur dëmi ka ardhur si rrjedhojë e gabimeve në projektimin apo ndërtimin e ndërtesës kryer prej vetë subjektit ndërtues, që është njëkohësisht dhe pronar i objektit.

Projektakti jep në mënyrë shteruese kuptimin e nocioneve të trajtuara në përmbajtjen e këtij projekti. Më konkretisht, sjell një sërë konceptesh të reja ku, ndërmjet të tjerave, mund të përmendim “*Zhvillimin e detyruar*” që përkufizohet si e drejta e autoritetit përgjegjës për të vendosur prishjen e ndërtesave dhe zhvillimin e territorit ku ndodhen ndërtesa apo një grup ndërtesash, në pronësi publike apo private, si rezultat i dëmtimit të tyre nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe që rrezikon jetën dhe shëndetin e banorëve si dhe për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me planin e detyruar vendor sipas parashikimeve të këtij ligji. Përkufizim i ndërlidhur me “*zhvillimin e detyruar*” është edhe koncepti i “*zonës së re për zhvillim*” që është territori që përcaktohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

Bazuar në direktivën 24/2014 të BE-së “Mbi prokurimin publik”, është përkufizuar “*prokurimi publik për rindërtimin*” si procedurë e përshpejtuar e prokurimit që zbatojnë autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe të ligjit për prokurimin publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, i cili mbështetet në parimet e transparencës, barazisë, konkurrueshmërisë etj.

Kreu II parashikon parimet e rindërtimit. Ky kre është mbështetur në parimet parashikuara në objektivat sociale të shtetit të sanksionuara nga neni 59 i Kushtetutës, si dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, strehimit të përshtatshëm, barazisë dhe mosdriminimit, informimit dhe transparencës dhe parimin e kontrollit dhe përgjegjshmërinë e burimeve financiare. Në thelb ky akt normativ përshkrohet nga koncepti “rindërto më mirë”.

Kreu III parashikon autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Në kuadër të zbatimit të këtij akti normativ, Këshilli i Ministrave gëzon kompetenca politikëbërëse për përballimin dhe rregullimin e pasojave të fatkeqësive natyrore e të fatkeqësive të tjera.

Një organ tjetër, të cilit i janë atribuar kompetenca specifike nëpërmjet këtij akti normativ, është Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, i cili krijohet nga Këshilli i Ministrave, në cilësinë e organit përgjegjës për propozimin e programit të përgjithshëm të rindërtimit dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve materiale e financiare për rehabilitimin e komuniteteve dhe rindërtimin e zonave të prekura nga fatkeqësia natyrore dhe për zhvillimin e zonave të reja.

Përbërja, organizimi, veprimtaria dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të llojit të fatkeqësisë dhe masave të nevojshme për përballimin e pasojave të ardhura nga fatkeqësia natyrore.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, e ngritur në zbatim të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, parashikohet të shërbejë si sekretariat teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe mbështetje për përmbushjen e detyrave prej tij.

Parashikohet që njësitë zbatuese të administrojnë fondet e transferuara nga Këshilli i Ministrave nga fondi i rindërtimit dhe veprojnë si autoriteti kontraktor në zhvillimin e procedurave të prokurimit për kontratat publike të studimit e të planifikimit të zonave të zhvillimit urban; ndërtimin e banesave të reja ose ndërtesave publike të dëmtuara; rikonstruksionin e banesave ose ndërtesave publike të deklaruara të pabanueshme; punimet e rikonstruksionit, rehabilitimit dhe ndërtimit në monumentet e trashëgimisë kulturore; realizimin e ndërtimeve në zonat e reja për zhvillim. Njësia zbatuese parashikohet të bashkëpunonjë me të gjitha institucionet publike përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kompetenca të posaçme në procesin e rindërtimit, ku përfshihet administrimi i fondeve të transferuara nga Këshilli i Ministrave; miratimi i planeve të detyruara vendore, planeve të detajuara vendore dhe lejeve të zhvillimit e të ndërtimit në funksion të procesit të rindërtimit sipas rregullave dhe procedurave të veçanta të parashikuara në këtë akt normativ. Në kuadër të mirëmenaxhimit të procesit të rindërtimit në nivel lokal, mund të krijohen zyra të posaçme për rindërtimin.

Kreu IV rregullon procesin e rindërtimit, i cili është trajtuar si një proces i integruar zhvillimi, i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të mjeteve të jetesës e të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Procesi i rindërtimit ndahet në katër programe kryesore:

- *Programi i zhvillimit të objekteve të reja.* Ky program konsiston në zhvillimin e objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse si dhe rikonstrukcionin e ndërtesave ekzistuese të dëmtuara nga autoritetet shtetërore; zhvillimin e objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim si dhe rindërtimin e ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore.
- *Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike* është programi me anë të të cilit, me financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët, ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.
- Programi i krijimit të fondit të banesave, që përbëhet nga programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë dhe programi i banesave të dhuruara nga subjektet private;
- Programi i granteve të rindërtimit. Ky program përbëhet nga granti për rindërtimin ose rikonstrukcionin e banesave të dëmtuara; pagesa e qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga fatkeqësia natyrore si dhe kompensimi i shpenzimeve të subjekteve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore;
- Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike, i përbërë nga programi i kompensimit të dëmeve nga fatkeqësia natyrore; masat për rimëkëmbjen sociale; masat për rimëkëmbjen ekonomike; masat rekuperuese dhe parandaluese.

Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet, të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave që do të rregullohen me akt nënligjor të Këshillit të Ministrave.

Akti normativ parashikon edhe një kategori vulnerabël që gëzon përparësi në përfitimin nga programet e rindërtimit për shkak të statusit social në të cilin gjendet, ku përfshihen familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore; familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna; familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara; të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit; familjet në skemën e ndihmës ekonomike; familjet e dëshmorëve dhe të rënëve në krye të detyrës.

Një risi e këtij projekti lidhet me zbatimin e procesit të shpronësimit të pasurisë së paluajtshme, si dhe shkëmbimin me një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit. Për të garantuar proporcionalitetin parashikohet që pasuria e paluajtshme që shkëmbehet nuk duhet të ketë vlerë më të ulët ekonomike se

prona për të cilën bëhet shkëmbimi. Për vlerësimin e pronës do të zbatohen rregullat dhe parimet e legjislacionit në fuqi.

Një element i rëndësishëm që trajtohet nga ky projekti është vlerësimi i thelluar i ndërtesave që kanë pësuar dëme nga fatkeqësia natyrore dhe që janë shpallur të pabanueshme nga aktkonstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit së qytetarëve. Studimi parashikohet të japë një konkluzion të qartë mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit. Pas dorëzimit të studimit të thelluar, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës kërkon oponencën teknike nga Instituti i Ndërtimit. Opinioni i Institutit të Ndërtimit mbizotëron mbi studimin e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.

Kreu V parashikon ngritjen e Fondit të Rindërtimit, që shërben për realizimin e programeve të procesit të rindërtimit do të jetë një zë i veçantë në buxhetin e shtetit dhe përbëhet nga:

- Programi i veçantë që krijohet nga të ardhura nga buxheti i shtetit dhe të ardhura nga dhurimi i personave juridikë apo fizikë, vendas dhe të huaj, organizma ndërkombëtarë, qeveri të shteteve të huaja;
- dhurimet e mallrave apo shërbimeve nga personat juridikë apo fizikë, vendas dhe të huaj, organizma ndërkombëtarë, qeveri të shteteve të huaja, që përbëjnë kontribute në natyrë.

Mënyrat e menaxhimit, përdorimit dhe transferimit të fondeve të programit të veçantë në buxhetin e shtetit, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit do të realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe buxhetor.

Një formë tjetër kontributi e parashikuar nga ky akt normativ është edhe kontributi në natyrë i tregtarëve ose shoqërive tregtare, vendase apo të huaja, që kontribuojnë me sende apo materiale ndërtimore në funksion të procesit të rindërtimit, si dhe me punë apo shërbime në funksion të procesit të rindërtimit.

Në funksion të transparencës dhe llogaridhënies në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve është parashikuar një procedurë e detajuar për auditimin dhe kontrollin financiar. Në këtë aspekt, parashikohet ngritja e portalit unik të rimëkëmbjes që publikon informacione mbi programet kombëtare të rindërtimit; fondet e rindërtimit, burimin e krijimit të tij, kontributet; informacion mbi

numrin e godinave të ndërtuara, të rikonstruktura, zonat e zhvilluara dhe zonat në zhvillim, procedurat e ndjekura etj.

Fondi i rindërtimit si dhe çdo autoritet tjetër, publik ose privat, që përdor fonde buxhetore nga fondi i rindërtimit i nënshtrohet edhe auditimit ligjor sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.

Kreu VI rregullon procedurat e posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera si dhe për zhvillimin e zonave të rejave për zhvillim. Kjo procedurë mbështetet në parimet dhe rregullat bazë që udhëheqin procedurën e prokurimit publik, por e përshtatur në funksion të urgjencës dhe nevojave të rimëkëmbjes për sa i takon lehtësimit të procedurave dhe afateve. Procedura e posaçme e parashikuar nga ky akt normative mbështetet në parimet e:

- përdorimit me efektivitet dhe efikasitet të fondit të rindërtimit;
- trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;
- integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e përdorimit të fondeve në dispozicion të procesit të rindërtimit.

Njësia zbatuese përdor procedurën e përshtetshme për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për rindërtimin e zonave të prekura. Konkurrimi për marrëveshje kuadër bëhet me detyrimin për paraqitjen e kapaciteteve teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare. Në ndryshim nga parashikimet e legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, për qëllime të këtij ligji, marrëveshja kuadër është marrëveshja që lidhet me operatorët ekonomikë në përfundim të fazës së parë kualifikuese për secilën procedurë prokurimi publik të procesit të rindërtimit.

Për qëllime të zbatimit të kësaj procedure, autoriteti kontraktor përgatit një ftesë për ofertë me krijimin e nevojës konkrete dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër. Jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së ofertave, përzgjedh ofertën fituese, me të cilën do të lidhë kontratën përkatëse.

Akti normative parashikon mundësinë e përdorimit të procedurës pa shpallje paraprake të njoftimit sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, për rastet e nevojave emergjente në verifikimin e dëmeve, blerjen e pajisjeve të rëndësishme parësore me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

Kreu VII rregullon deregullimin e procesit të pajisjes me leje/licenca/autorizime të individëve ose personave juridikë në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, gjeodezisë ose profesioneve të tjera të nevojshme në procesin e rindërtimit, të cilët kanë bërë kërkesë dhe janë në proces për licencim. Njëkohësisht, procesit të deregullimit i nënshtrohen procedurat e njohjes së licencave të personave fizikë dhe juridikë të huaj, të cilët kanë njohuri të natyrës profesionale ose teknike në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, gjeodezisë ose profesioneve të tjera të nevojshme në procesin e rindërtimit.

Kreu VIII trajton përjashtimet nga taksat dhe tatimet, tarifat e aplikimit për shërbime në administratën shtetërore në kuadër të procesit të rindërtimit. Këto përjashtime do të rregullohen nga legjislacioni i posaçëm fiskale.

Në këtë kre trajohet edhe mundësia e përfitimit të lehtësirave për pagesat e konsumit të ujit dhe energjisë elektrike gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore për individët dhe familjet që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë nga fatkeqësia natyrore.

Një formë lehtësie është edhe bashkëpunimi me sektorin bankar në mënyrë që individët dhe familjet që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë dhe/ose të papunë nga fatkeqësia natyrore të lehtësohen nëpërmjet ristrukturimit të afateve, kushteve dhe termave të kredive gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Me zbatimin e këtij akti normativ ngarkohen autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore të cilat janë:

- Këshilli i Ministrave;
- Komisioni Shtetëror i Rindërtimit;
- Ministri përgjegjës në fushën e përgjegjësisë së të cilit, përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera;
- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- Njësitë zbatuese;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. HARTIMI I PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar me kontributin e një sërë ministrive dhe institucioneve shtetërore që kanë kompetenca në fushën e zbatimit të këtij

projektakti, nën mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë dhe asistencës së ekspertëve të misionit EURALIUS V.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky akt normativ shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit në lidhje me ngritjen e Fondit të Rindërtimit, i cili do të parashikohet si një zë i veçantë në ligjin e buxhetit vjetor përkatës.

Njëkohësisht akti normativ ka impakt edhe në ardhurat buxhetore për shkak të lehtësirave fiskale dhe lehtësirave të tjera të parashikuara nga akt normativ si dhe ligjet e posaçme fiskale, të cilat do të llogariten sipas fazave përkatëse të miratimit të fondit përkatës sipas kërkesave së gjëndjes së urgjencës së krijuar, e cila është e pamundur të përlllogaritet në këtë fazë.

KËSHILLI I MINISTRAVE